**AKT – THEMELIMI**
**I**
**SHOQËRISË**
**"BRRUT - OIL" SHA**

## 1. EMRI DHE FORMA LIGJORE E SHOQËRISË

Emri i shoqerisë do të jetë **"BRRUT OIL" SHA,** nga këtu e më poshtë referuar si "Shoqëria". Shoqëria është e organizuar si shoqëri tregtare e formës aksionare (SHA).

## 2. AKSIONARET E SHOQËRISE

Shoqëria është themeluar nga Aksionari i Vetëm:

- **Hysen Kastrati**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.08.1984, mbajtes i kartës së identitetit me nr. 037302048 dhe nr. Personal I40805059P.

## 3. SELIA E SHOQËRISË

2.1 Shoqëria ka selinë e saj në adresën: **Durrës, Porto Romano, Fshati Rinia, nr. pasurie 64/119, zona kadastrale 3184.**

- Shoqëria mundet të shtrijë aktivitetin e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mundet të themelojë degë, ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë tij.
- Selia e shoqërisë mundet të transferohet kudo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me nje vendim të Asamblesë së aksionarëve të shoqërisë.

## 4. OBJEKTIVI I AKTIVITETIT

Shoqëria mund të kryejë në Republikën e Shqipërisë, çdo aktivitet që nuk ndalohet nga ligji në fuqi, të tillë si, por pa u kufizuar në:

- *Krijimi, instalimi dhe venia në shfrytëzim sipas kushteve teknike të impianteve, stacioneve, reparteve, linjave për tregtimin e hidrokarbureve brenda e jashtë vendit;*
- *import-eksport dhe tregti me shumicë e naftës, gazit, nënprodukteve të tyre, vajrave*

*lubrifikante, transporti kombëtar e ndërkombëtar i tyre;*

- *import-eksport dhe tregti me shumicë e pakicë të teknologjisë dhe pjesëve të këmbimit për ushtrimin e veprimtarisë hidrokarbure, të automjeteve të transportit hidrokarbur, të kokave dhe cisternave, bote për to dhe për depozita stacionare të bombolave me ose pa mbushje gazi si dhe dhënien e asistencës teknike për to,*
- *ndërtimin dhe venien në përdorim të depove hidrokarbure, rezervuareve të linjave dhe pikave të shitjes së tyre sipas projektit teknologjik;*
- *import-eksport dhe tregti me shumicë e pakicë të artikujve industrial, bujqësore, blektorale, ushqimore, ndërtimore, elektroshtëpiake, audiovizive, elektrike, të makinerive për ndërtim;*
- *ndërtimin e çdo godine, qendra biznesi, hotele, bar-restorante, magazina, parking, komplekse turistike, depo stacionere për karburante e nënprodukteve të tyre;*
- *ngritjen dhe vënien në shfrytëzim të poligoneve të ndërtimit për prodhimin e materialeve inerte të betoneve, penobetoneve dhe të çdo materiali ndërtimor parafabrikat;*
- *ndertime të impianteve të pastrimit të mbeturinave civile dhe industriale, për ngritjen dhe restaurimin e rrjetit bonifikues të vaditjes dhe kullimit, punime dhe kanalizime për rrjetet e jashtme dhe të brendshme të ujësjellësve e të çdo rrjeti tjetër të sistemit hidrik;*
- *prodhim guri, punime çimentimi, injective detare, shtrirje kabllosh e tubacionesh nënujore,*

  *ndërtimin e urave, rrugëve urbane e interurbane, asfaltimin e tyre,*
- *kryerjen e veprave të artit, agjenci turistike, doganore, spedicionere, të transportit tokësor, detar e ajror civil, të pasagjerëve e mallrave,*
- *hapjen e zyrave të projektimit dhe zbatimit,*
- *dhënien e asistencës teknike të supervizionit, të kolaudimit dhe të ekspertizës ndërtimore për nevojat e të tretëve.*
- *ushtrimin e aktivitetit të grumbullimit, demolimit dhe shitblerjes së skrapit, hekurishteve dhe mbeturinave të tyre.*
- *grumbullim, magazinim, përpunim, riciklim, transport dhe asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.*
- *furnizim me karburant dhe lubrifikant për mjetet lundruese (detare) si dhe Jet-A1 për mjetet fluturuese ajrore.*

## 5. PERIUDHA E AKTIVITETIT

- Periudha e aktivitetit të shoqërisë është **me afat të pacaktuar,** afat që fillon nga data e regjistrimit pranë Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB).
- Cdo ndryshim ne lidhje me periudhën e aktivitetit mundet të bëhet vetëm me vendim

të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë.

## 6. KAPITALI THEMELTAR

- Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.500.000 lekë.
- Kapitali aksionar i shoqërisë është ndarë në 100 aksione të zakonshme me një vlerë nominale 35.000 leke secili.

  Aksionari themelues i Shoqërisë, **Hysen Kastrati** mbajtes i kartës së identitetit me nr. 037302048 dhe nr. Personal I40805059P, zotëron 100 % të aksioneve me vlerë nominale prej 35.000 leke secili.

## 7. ORGANET VENDIMARRËSE TË SHOQËRISË

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

a. *Asambleja e Pergjithshme (kompetencat e se cilës ushtrohen nga Aksionari i Vetëm, përsa kohë shoqëria do të ketë vetëm një aksionar).*
b. Administratori.
c. Keshilli Mbikëqyrës.

## 8. ADMINISTRATORI.

Administratori i parë i shoqërisë është:

**Hysen Kastrati,** shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.08.1984, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 037302048 dhe nr. personal I40805059P.

Mënyra e emërimit, e shkarkimit, të drejtat dhe detyrimet e administratorit, si dhe koha e qëndrimit në detyrë të tij, përcaktohen në Statut dhe në ligj.

## 9. KËSHILLI MBIKQYRËS.

Anëtarët e parë të Këshillit Mbikëqyrës janë:

- **Uruç Memishaj**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 18.02.1965, mbajtes i kartës së identitetit me nr. 034092303 dhe nr. personal G50218149N.

- **Besnik Peka**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.01.1993, mbajtes i pasaportës me nr. BG6144143 dhe nr. personal J30105070U.

- **Ermal Hoda** shtetas shqiptar, e datelindjes 24.07.1988, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. 035825557 dhe nr. personal I80724087Q.

## 10. MBYLLJA (LIKUIDIMI) I SHOQËRISË

Në rast të falimentimit të kompanisë, procesi i likujdimit do të realizohet në përputhje me procedurat ligjore në fuqi në momentin e falimentimit.

**<u>AKSIONARI I VETËM</u>**

**Hysen Kastrati**

Hysen Kastrati

**Durrës, më 20.04.2023**